



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:084494

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05649264

C.nr.101/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, me bashkëpunëtoren profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. Th. nga, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Arbër Spahiu dhe Vlora Kadriu, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, me vlerë të kontestit 350.00 euro, jashtë seancës, më datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit A. Th. nga dhe Detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës, që paditësit në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim ditorë, për periudhën nga data 04.02.2023 deri më datë 06.03.2024, për 175 ditë pune, t’ia paguaj shumën e të hollave prej **350.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë 13.03.2024, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura, që paditësit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 98.00 euro, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës edhe atë për përpilimin e padisë, në shumë prej 26.00 euro, Refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m i

Paditësi, përmes të autorizuarve të tij, më datë 13.03.2024, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore, me vlerë të kontestit prej 350.00 euro. Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune të paditura në SHFMU "17 Shkurti", në fshatin Muçivërc, Komuna e Kamenicës, në pozitën e mësimitdhënësit. Baza ligjore për kompensimin e shujtës ditore në lartësi 2 euro, për 175 ditë pune, ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive në Nivel të Ndërmarrjes, të dt.31.01.2020, në nenin 16 parag.1, e lidhur ndërmjet Komunës së Kamenicës

dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës të Kosovës. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 104 euro për përpilimin e padisë, si dhe shumën prej 20 euro për taksën gjyqësore.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësit.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka theksuar se është i pakontestueshëm fakti se paditësi është në marrëdhënie pune të e paditura, po ashtu ka theksuar se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë matëriale se Komuna e Kamenicës, ne draft buxhetin për vitin 2023, është paraparë ndarje e ndonjë pjese të buxhetit për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, dhe se duke u bazuar në ndarjet buxhetore për vitin 2023 për sektorin e arsimit në Komunën e Kamenicës, në kategorinë e shpenzimeve ne pjesën e IV shihet se nuk ka ndarje buxhetore. Në bazë të nenit 16 parag.1, e paditura për shkak të mungesës së buxhetit dhe pa mundësisë financiare nuk ka bërë ndonjë ndarje specifike për kompensimin e shujtës ditore prej së paku 2 (dy) euro, për një ditë pune, me tutje ka shtuar se e kundërston kërkesëpadinë e paditësit edhe nga fakti se palët nënshkruese të kësaj kontrate kanë shprehur në mënyrë deklarative mundësinë e vullnetit të përmbushjes së nenit 16, nga të lartëcekurat i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartasi se padia e paditësit është tërësisht e bazuar.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “*kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU ”17 Shkurti”, në fshatin Muçivërc, Komuna e Kamenicës, në pozitën e mësimdhënësit.

Andaj, gjykata sa i përket të drejtës subjektive të paditësit dhe lartësisë së tij, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive në nivel të Ndërmarrjes, të datës 31.01.2020, konkretisht nenin 16 paragrafi 1 të kësaj Kontrate, ku citohet se 1.“*Sipas mundësisë financiare të Punëdhënësit, të punësuarit do të kompensohen ne emër të shujtës ditore në shumë prej së pagu 2 (dy) euro për një ditë pune; 2. Kompensimi ne emër të shujtës ditore do të bëhet nga Punëdhënësi në bazë mujore, në periudhë korelative me kompensimin e pagës mujore*” ndërsa

ne nenin 4 parag.3 citohet *“Te gjitha të drejtat dhe detyrimet që janë të përcaktuara me Ligjin e Punës, Kontratën e Përgjithshme Kolektive dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, e që shprehimisht nuk janë të specifikuara me dispozita të veqanta të KKN-së, janë të zbatueshme plotësisht dhe si të tilla vërtetohen si obligim i palëve kontraktuese ne këtë KKN ”*. Andaj, gjykata e obligoj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj për 175 ditë pune, shumën prej 350.00 euro, në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë, nga data 04.02.2023 e deri më datë 06.03.2024.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditësi është i punësuar pranë të paditurës, as fakti se i njëjti, ka gjithësej 214 ditë pune, (fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi nr.202, i dt.04.03.2024, i leshuar nga SHFMU “17 Shkurti”, në fshatin Muçivërc, Komuna e Kamenicës, në emër të paditësit), por kontestues është fakti se a ka bazë ligjore për kompensim e shujtës ditore.

Në bazë të nenit 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës, gjykata i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë leshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Me Ligjin e Punës nr.03-L/212 parashihet se sa i përket çështjeve të punëdhënësit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund t’i rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me Ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur në përgjigje në padi, se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë materiale se Komuna e Kamenicës, në draft buxhetin për vitin 2023, të ketë paraparë ndarjen e ndonjë pjese të buxhetit për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive në kuadër të Ndërmarrjes, dhe se duke u bazuar në ndarjet buxhetore për vitin 2023 për sektorin e arsimit në Komunën e Kamenicës, në kategorinë e shpenzimeve në pjesën e IV shihet se nuk ka ndarje buxhetore, për gjykatën këto pretendime ishin të pa bazuara, për faktin se me nenin 1, të Kontratës Kolektive në kuadër të Ndërmarrjes, citohet se *“KKN lidhet nga palët në këtë kontratë për avancimin e rregullimit të marrëdhënieve juridike nga marrëdhënia e punës dhe respektimit të të drejtave dhe detyrimeve të palëve nënshkruese”*, prandaj, Komuna e Kamenicës, është e obliguar ta zbatojnë KKN dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, po ashtu duke u bazuar në nenin 2, të kësaj kontrate, ku citohet se *“Kjo kontratë zbatohet në marrëdhënie të punës vetëm për të punësuarit në sektorin e arsimit të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut, brenda territorit të Komunës së Kamenicës, si njësi unike e punës”*, paditësi, në rastin konkret, hynë në kuadër të përfituesve të të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë, meqë i njëjti është i punësuar të e paditura. Andaj, përgjegjësia për kompensimin shujtës ditore është te e paditura, respektivisht të DKA-së, në Kamenicë.

Gjykata për kamatën ligjore prej 8 % ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së).

Gjykata pjesën tjetër të shpenzimeve të procedurës edhe atë për përpilimin e padisë në shumë prej 26.00 euro, e refuzoi si të pa bazuar nga fakti se sipas Tarifës së OAK-së, edhe atë nr.tarifor.6, shuma e kompensimit të shpenzimeve të procedurës për përpilimin e padisë në kontestet e vlerës së vogël, kompensohen në shumë prej 78.00 euro, prandaj gjykata ka vendosur që palës paditëse t'i njohë pjesërisht shpenzimet e procedurës.

Gjykata duke patur parasysh suksesin në procedurë të paditësit dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463, parag. 1 të LPK-së, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë, shumën prej 78.00 euro dhe për taksë gjyqësore, shumën prej 20.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 98.00 euro.

Gjykata, nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN –DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.101/2024, më datë 02.05.2024

Gjyqtari,
Artan Abazi d.v

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimi të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.